



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1234_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2013_12_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **22.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L. B. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90111950 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2013_12_19** i datës 17.12.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.08.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: ekipet e KEDS kanë konstatuar gjendjen e njehsorit elektrik nr.39360867 prej TL=2699 kWh dhe TU=1804 kWh përmes procesverbalit nr.0390506 të datës 26.03.2015, dhe në të cilën procesverbal theksohet se objekti është pa pëlqim elektroenergjetik. Në ankesë është theksuar se nuk qëndron argumenti i DMK në ZRRE se nuk është argumentuar shpenzimi njehsorit nr.39360867 pasi që ekipet e KEDS kanë konstatuar se njehsori nr.39360867 është i kyçur në rrjetin pa pëlqim elektroenergjetik dhe duhet të faturohet. Në ankesë është theksuar se përderisa nuk është bërë Pëlqimi Elektroenergjetik për objektin kolektiv nuk është mundur të faturohet konsumatorit dhe në momentin kur është bërë PEE dhe janë regjistruar njehsorët është bërë edhe faturimi i energjisë elektrike me emër të pronarëve të secilës banesë sipas listës së pronarëve dhe listës së KEDS për njehsorët ilegal. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2013_12_19 i datës 17.12.2019 për konsumatorin L. B. me shifër DPR – 90111950.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se ekipet e KEDS kanë konstatuar gjendjen njëhësorë elektrik nr.39360867 prej TL=2699 kWh dhe TU=1804 kWh përmes procesverbalit nr.0390506 të datës 26.03.2015, dhe në të cilën procesverbal theksohet se objekti është pa pëlqim elektroenergjetik, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe organi i shkallës së parë në ZRRE gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, respektivisht procesverbalit të lartcekur të datës 26.03.2015 ka konstatuar se punëtorët e autorizuar të KEDS gjatë inspektimit të objektit kolektiv kanë evidentuar një numër të konsiderueshëm të njëhësorëve elektrik, si dhe gjendjen e përgjithshme të shpenzimit të energjisë elektrike të këtyre njëhësorëve, si dhe duhet potencuar se ky procesverbal është përpiluar në emër të Objekti Banesor "Prishtina e Re" dhe jo në emrin e konsumatorit L. B. Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë procesverbalit nr. nr.0390506 thekson se punëtorët e autorizuar përveç evidentimit të njëhësorëve elektrik, gjendjen e përgjithshme të shpenzimit të energjisë elektrike, si dhe shkyçjen e kabllit të furnizimit, nuk kanë evidentuar saktë cili njëhësor cilën banesë e furnizon me energji elektrike. Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për pranim të instalimit të njëhësorëve elektrik me datë 21.04.2016 kanë bërë pranimin e njëhësorit nr.39700119 me gjendje TL=4648 kWh dhe TU=3244 kWh dhe i regjistruar në emër të L. B. si dhe punëtorët e KEDS kanë evidentuar se pranimi teknik i instalimit të njëhësorit elektrik bëhet bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk qëndron argumenti i DMK në ZRRE se nuk është argumentuar shpenzimi njëhësor nr.39360867 pasi që ekipet e KEDS kanë konstatuar se njëhësori nr.39360867 është i kyçur në rrjeti pa pëlqim elektroenergjetik dhe duhet të faturohet, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizave të bëra procesverbalit të inspektimit nr.0390506 të datës 26.03.2016, procesverbalet e pranimit teknik të njëhësorit nr.39700119, si dhe procesverbalet mbi ndërrimin e njëhësorëve nr.0589585 të datës 10.05.2016 dhe nr.0607728 të datës 10.05.2016, konstaton se ekziston kundërthënie mes provave të evidentuara të KEDS, si dhe argumentimit se njëhësori elektrik nr.39360867 ka qenë i vendosur me herët nga konsumatori për matje, pasi që pikërisht pranimi i parë teknik nga ekipi i KEDS-it është bërë për njëhësorin elektrik nr.39700119 në emrin e konsumatorit L. B. si dhe është evidentuar që ky njëhësor furnizon banesën nr.9. Bordi i ZRRE po ashtu thekson se sipas procesverbalit e inspektimit nr.0390506 të datës 26.03.2016 vërtetohet se është evidentuar njëhësori elektrik nr.39360867, duke mos e potencuar se cilën banesë e furnizon me energji elektrike. Madje duhet theksuar se në procesverbalin e ndërrimit të njëhësorit elektrik nr.0589585 dhe nr.0607728 të datës 10.05.2016 shihet se ka paqartësi, pasi në procesverbalin nr.0589585 theksohet se konsumatori nuk prezanton njëhësorin nr.39360867, ndërsa në procesverbalin nr.0607728 theksohet se largohet njëhësori nr.39700119 me gjendje TL=5120 kWh dhe TU=3480 kWh dhe nr.39360867 me gjendje TL=2699 kWh dhe TU=1804 kWh, e që këto dy procesverbale të vet KEDS-it janë në kundërshtim me njëra tjetrën pasi që në njërin procesverbal theksohet se konsumatori nuk e prezanton njëhësorin e në procesverbalin tjetër arrijnë edhe të evidentohet gjendja e shpenzimit të njëhësorit nr.39360867 të cilën sipas KEDS konsumatori nuk e prezanton.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se përderisa nuk është bërë Pëlqimi Elektroenergjetik për objektin kolektiv nuk është mundur të faturohet konsumatorit dhe në momentin kur është bërë PEE dhe janë regjistruar njëhësorët është bërë edhe faturimi i energjisë elektrike me emër të pronarëve të secilës banesë sipas listës së pronarëve dhe listës së KEDS për njëhësorët ilegal, Bordi i ZRRE-së thekson se Rregulla për Kushtet e Përgjithshme e Furnizimit me Energji e specifikon qartë mundësinë e kyçjes së konsumatorëve në rrjetin elektrik. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se në rastet kur një konsumator kyçet në rrjetin elektrik pa autorizim të KEDS-it dhe nuk ka pëlqim për kyçje atëherë KEDS do të duhej të merrte masa konkrete që ai konsumator të shkyçet nga rrjeti elektrik, pra të eliminohet mundësia e furnizimit të atij konsumatori me energji elektrike pa autorizim të KEDS-it dhe të merren masa konkrete lidhur me shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike nga ana e konsumatorit konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike, Rregullës për Kushtet e



Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Ndërsa sa i përket pikës së KEDS-it se në momentin kur është bërë PEE dhe janë regjistruar dhe faturuar njehsorët sipas listës së pronarëve të banesave, si dhe pohimit të KEDS-it se ata kanë pasur të dhëna se për secilin njehsor se cilën banesë e furnizon, Bordi i ZRRE-së thekson në procesverbalin nr.26.03.2015 nuk është evidentuar asnjë e dhënë se cili njehsor cilin banesë e furnizon, ndërsa KEDS nuk ka prezantuar asnjë listë të pronarëve të banesave lidhur me objektin në fjalë, madje nuk është dhënë asnjë sqarim i tillë i KESCO-s as në përgjigjen e tyre për konsumatorin e që do të duhej të ipej arsyetim konkret për faturimin nr. 0716210393DPR-90111950 të datës 01.08.2016 në vlerë 295.77€.

Bordi i ZRRE-së thekson se KEDS/KESCO nuk kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim".*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit L. B. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.